Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0324
Data e Vendimit: 20.06.2023

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, pas shqyrtimit të ankesës së Operatorit Ekonomik "JIHUA 3502 CAREER APPAREL LTD" kundër njoftimit të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me uniforma për detyra taktike" me numër të prokurimit 214-23-2841-1-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS, Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Vjosa Gradinaj Mexhuani me datën 20/06/2023, mori këtë:

Vendim

Hedhet si e palejuar ankesa operatorit ekonomik OE "JIHUA 3502 CAREER APPAREL LTD" me Nr. të protokollit 2023/0324, e parashtruar me 30/05/2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me uniforma për detyra taktike" me numër të prokurimit 214-23-2841-1-1-1, iniciuar nga POLICIA E KOSOVËS. në cilësinë e autoriteti kontraktues (AK).

I lejohet, Autoritetit Kontraktues – POLICIA E KOSOVËS që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me uniforma për detyra taktike", me numër të prokurimit 214-23-2841-1-1-1, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

Në përputhje me nenin 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale-

Me 30.05.2023, Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik ka pranuar ankesën me Nr. të Protokollit 324/23 nga OE "JIHUA 3502 CAREER APPAREL LTD". Ankesa ndërlidhet me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me uniforma për detyra taktike", me numër të prokurimit 21423-2841-1-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS.

AK -POLICIA E KOSOVËS, ka publikuar Njoftimin për Kontratë në lidhje me aktivitetin e cituar me sipër me datë 28.03.2023.

Me 22.05.2023 Autoriteti Kontraktues ka publikuar B54 Formularin Standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara sipas këtij formulari afati i fundit për pranim të tenderëve ishte data 02.06.2023.

Me 29.05.2023 OE "JIHUA 3502 CAREER APPAREL LTD" kishte parashtruar kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së. Ndërsa me 31.05.2023 AK ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik si të pa lejueshme me arsyetimin se afati i fundit për dorëzimin e tenderëve ka qenë data 02.06.2023 ndërsa kërkesa për rishqyrtim nga operatori ekonomik ankues është paraqitur nga 29.05.2023 mbas orës 16:00, edhe pse afati i fundit për paraqitjen e kërkesës për rishqyrtim është 29.05.2023 ora 16:00.

- *Vlerësimi dhe administrimi i provave –*

Nga provat e prezantuara vërtetohet se për aktivitetin e prokurimit "Furnizim me uniforma për detyra taktike", me numër të prokurimit 214-23-2841-1-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS, konstatohet se sipas njoftimit të kontratës të publikuar në sistemin e-prokurimi me datë 28.03.2023, afati i fundit për pranim të tenderëve ishte data 02.06.2023. Ndërsa me datë 29.05.2023 ora 16:23 OE "JIHUA 3502 CAREER APPAREL LTD" kishte bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së. Autoriteti Kontraktues me datën 31.05.2023 ka refuzuar si të pa lejueshme kërkesën për rishqyrtim të Operatorit ekonomik ankues.

Ankuesi ka qenë i obliguar që në pajtim me paragrafin 3.1 të nenit 108/A të LPP-së, brenda afateve ligjore të parashtroj kërkesë për rishqyrtim në AK dhe vetëm pas udhëheqjes së procedurave paraprake në AK, Operatori ekonomik në pajtim me nenin 109 të LPP-së do të mund ti drejtohet me ankesë OSHP-së.

Neni 108/A paragrafi 3.1 i LPP-së përcakton se operatori ekonomik ankues kërkesën për shqyrtim duhet të dorëzoj tek autoriteti përkatës kontraktues: *në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit brenda pesë (5) ditëve para afatit të fundit për dorëzim të ofertave*.

Po ashtu, edhe neni 60.1 pika a) në Rregulloren 001/2022 për Prokurim Publik përcaktohen se: *Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit se paku pesë (5) ditë para afatit të fundit për dorëzim të ofertave. Në kalkulim të afateve kohore dita e dorëzimit të ofertave është dita (0).*

Konstatohet se ankesa e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 30.05.2023 nga OE "JIHUA 3502 CAREER APPAREL LTD" për aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me uniforma për detyra taktike", me numër të prokurimit 214-23-2841-1-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS, hedhet si e pa lejuar sepse ankuesi nuk ka

parashtruar kërkesën për rishqyrtim brenda afateve ligjore kundër njoftimit të Autoritetit Kontraktues. Andaj Organi Shqyrtues i Prokurimit sqaron se vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake të rregullt dhe brenda afateve ligjore pranë AK, ankuesi mund ti drejtohet me ankesë OSHP-së.

Si përfundim kjo ankesë është në kundërshtim me nenin 108/A dhe 109 të Ligjit për Prokurim Publik, dhe nenit 60 të Rregullores 001/2022 për Prokurim Publik, dhe si e tillë hedhet si e pa lejuar dhe nuk hynë në shqyrtim nga OSHP.

Megjithatë, OSHP i vë në dijeni AK, se në çdo aktivitet duhet të veproj konfom dispozitave dhe autorizimeve ligjore siç parashihen ato me nenin 1,6,7, 27,28,59,60,65 te LPP-së.

Lidhur me tarifën ankimore bazuar edhe në emalin e datës 07.06.2023 nga ALL MAKES GLOBAL SERVICES përmes të cilëve është konfirmuar se për këtë aktivitet te prokurimit janë në marrëveshje konzorciumi kompania NPSH ALLMAKES GLOBAL SERVICES dhe JIHUA 3502 CAREER APPAREL LTD, si dhe në bazë të autorizimit të bashkangjitur konfirmohet nga kompania JIHUA 3502 CAREER APPAREL LTD ku deklaron se AGS është përfaqësues ligjor për Kosovë andaj vendoset në përputhje me nenin 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së, që operatorit ekonomik ankues ti kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Kryetarja e OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vjosa Gradinaj
Kryetare e OSHP-së

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **POLICIA E KOSOVËS**
- OE - **JIHUA 3502 CAREER APPAREL LTD.**
- Arkivës së OSHP-së: